REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN
BELEDIYESI

471
16-07-2014

**Për:** ***z. Mehmet Muçaj,*** ***auditor në Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës***

**Nga:** ***z. Lutfi Haziri - Kryetar i Komunës së Gjilanit***

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM
KANCELARIJA GENERALNOG REVIZORA / OFFICE OF THE AUDITOR GENERAL
DATA PRANUAR / DORËZUAR 17. 07. 2014
Shifra e klasifikimit 22.18
Nr. Regj. 367

# PLANI I VEPRIMIT PËR IMPLEMENTIMIN E REKOMANDIMEVE
# të dhëna në Raportin nr. 22.18.1-2013-08 nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm

**Korrik 2014**
**Gjilan**

**PLANI PËR IMPLEMENTIMIN E REKOMANDIMEVE**
**të dhëna në Raportin nr.22.18.1-2013-08, pranuar nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm me 17.06. 2014**

**TITULLI I AUDITIMIT: - RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE TË KOMUNËS SË GJILANIT PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31.12.2013**

| Rekomandimet | Të pranuara PO/JO | Data e Pranuar | Data e propozuar e implementimit nga OB | Personi (at) përgjegjës | Shënimet |
|---|---|---|---|---|---|
| *1* | *2* | *3* | *4* | *5* | *6* |
| **Rekomandimi 1 :**<br>Kryetari duhet të analizoj arsyet për keq deklarimet materiale lidhur me pagesat nga palët e treta dhe dështimi për të ndjekur këshillat e ZAP-it për të siguruar prezantim të saktë të këtyre pagesave. | PO | 09.07.2014 | 31.10.2014 | Menaxheri i zyrës së projekteve dhe koordinatoro për menaxhimin e investimeve. | |
| **Rekomandimi 2**:<br>Kryetari duhet të identifikojë arsyet për keq deklarimin fillestar të pasurive dhe dështimin për ndjekur këshillat e ZAP-it. Procese të duhura duhet të vendosen në vitin 2014 për të siguruar prezantim të saktë të pasurive në PVF. | PO | 09.07.2014 | 31.12.2014 | Zyrtari llogaritar për Inventar. | |
| **Rekomandimi 3:**<br>Kryetari duhet të sigurojë që kërkesa nga plani i hartimit të PVF 2014 për rishikimin e draft llogarisë nga menaxhmenti zbatohet me fokus të veçantë në fushat që konsiderohen me rrezik të lartë të gabimit. Deklarata e bërë nga ZKA dhe ZKF lidhur me saktësinë e PVF-ve nuk duhet të dorëzohet pa u siguruar se janë zbatuar të gjitha kontrollet relevante për PVF-të. | PO | 09.07.2014 | 31.10.2014 | ZKF<br>Dhe<br>ZKA | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **Rekomandimi 4:**<br><br>Kryetari i Komunës duhet të siguroj se një plan i rishikuar, praktik njëkohësisht edhe sfidues, është hartuar për të adresuar rekomandimet e bëra nga Auditori Përgjithshëm, duke caktuar stafin përgjegjës me një fokus fillestar në fushat më të rëndësishme. Zbatimi i këtij plani duhet të rishikohet nga kryetari në baza mujore. | PO | 09.07.2014 | 17.07.2014 | Kryetari i Komunës dhe Drejtorët e drejtorive | |
| **Rekomandimi 5 :**<br><br>Kryetari i Komunës duhet të sigurojë se një strukturë e përshtatshme qeverisëse është zbatuar përmes së cilës menaxhmenti i lartë është i informuar për mangësitë e kontrollit dhe në mënyrë aktive i menaxhon ato. | PO | 09.07.2014 | | Kryetari i Komunës dhe Drejtorët e drejtorive | |
| **Rekomandimi 6**:<br><br>Kryetari i Komunës duhet të siguroj që aktivitetet e ndërtimit të monitorohen vazhdimisht në mënyrë që të hyrat e parapara të mblidhen në kohë. | PO | 09.07.2014 | Ka filluar TASK forca për grumbullimin e borgjeve | Drejtoria e Urbanizmit dhe drejtori i Inspekcionit | |
| **Rekomandimi 7** :<br><br>Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që sa më parë që kjo çështje të ngritet në asamble komunale për të gjetur një zgjidhje të përshtatshme për të mbikëqyrur projektet duke siguruar pavarësinë dhe shmangur konfliktin e mundshëm të interesit. | PO | 09.07.2014 | 09.07.2014 | Kryetari i Komunës në bashkëpunim me Zyrën e prokurimit | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **Rekomandimi 8**:<br><br>Kryetari të siguroj se në rastet kur mbikëqyrja bëhet nga punonjësit e komunës, të sigurohet që të ruhet objektiviteti dhe pavarësia e organeve mbikëqyrëse duke caktuar persona të pavarur. | PO | 09.07.2014 | 09.07.2014 | Kryetari i Komunës dhe drejtori i Zyrës e prokurimit | |
| **Rekomandimi 9**:<br>Kryetari i Komunës të siguroj një monitorim të shtuar të komisioneve vlerësuese nga menaxheri i prokurimit gjatë vlerësimit të ofertave dhe aty ku vërehen indikacione të bashkëveprimit të ofertuesve, të raportohen tek menaxhmenti i lartë dhe të veprohet konform legjislacionit. | PO | 09.07.2014 | 09.07.2014 | Kryetari i Komunës dhe drejtori i Zyrës e prokurimit | |
| **Rekomandimi 10**:<br>Kryetari i Komunës të siguroj se ekzistojnë kontrolle të duhura për shpenzimet e drekave zyrtare, me theks të veçantë këtyre shpenzimeve duhet t"iu paraprij një proces i aprovimit që kërkon dëshmi të duhura dhe të mjaftueshme për të demonstruar qëllimin dhe koston e këtyre organizimeve. | PO | 09.07.2014 | 09.07.2014 | Zyrtari Çertifikues dhe zyrtari shpenzues | |
| **Rekomandimi 11**:<br><br>Kryetari i Komunës duhet te siguroj që fillimisht të zhvillohen procedurat e prokurimit dhe pastaj të bëhen pagesat për kryerjen e shërbimeve duke u bazuar në kontratat valide. | PO | 09.07.2014 | 09.07.2014 | Drejtori i zyrës së Prokurimit dhe drejtorët e drejtorive | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **Rekomandimi 12:**<br><br>Kryetari i komunës duhet të rishikoj arsyet pse rregulloret nuk janë ndjekur në këtë fushë dhe të siguroj që kontrolle të duhura zbatohen për t"u siguruar që rekrutimet e ardhshme bëhen në përputhshmëri me ligjet relevante. | PO | 09.07.2014 | Gusht 2014 | Drejtori i drejtorisë së ARSIMIT | |
| **Rekomandimi 13:**<br><br>Kryetari i komunës të siguroj se procesi i subvencionimit të zhvillohet në përputhje me rregulloren e aprovuar dhe që të ketë një monitorim më të afërt për mënyrën e shpenzimit të subvencioneve. | PO | 09.07.2014 | Gusht 2014 | Kryetari i Komunës dhe drejtoritë që ndajnë subvencione | |
| **Rekomandimi 14:**<br><br>Kryetari i Komunës të rishikoj mundësinë e zvogëlimit të llogarive arkëtueshme në mënyrë që të financoj projektet kapitale të komunës si dhe të hartoj një plan veprimi për mbledhjen e borxheve. | PO | 09.07.2014 | Ka filluar TASK forca për grumbullimin e borgjeve | Drejtori i Buxhetit, Drejtori i Zhvillimit ekonomik, Drejtori i Urbanizmit, Drejtori i shërbimeve publike, Drejtori i Kadastri. | |
| **Rekomandimi 15:**<br><br>Kryetari i Komunës duhet të rishikoj çështjen e obligimeve të pa paguara duke diskutuar me të gjitha nivelet (MF-në dhe Qeverinë) si dhe të krijoj një strategji adekuate për të menaxhuar dhe mbajtur nën kontroll obligimet. | PO | 09.07.2014 | 17.07.2014 në Kuvendin e Komunës do të shqyrtohet kjo kërkesë të veprojmë dhe do të veprohet | Kryetari i Komunës dhe Drejtori i Buxhetit | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | sipas vendimit që do të nxirret. | | |
| **Rekomandimi 16:**<br><br>Kryetari duhet të sigurojë se aktiviteti i ardhshëm i AB-së të orientohet në auditimet vitit aktual në mënyrë që t"i ofroj menaxhmentit siguri të vazhdueshme për sa i përket efektivitetit të sistemeve të kontrollit të brendshëm për të gjitha rrjedhat e të hyrave dhe shpenzimeve domethënëse. Për më tepër, Komiteti i auditimit duhet të bëjë një plan pune ku do t"i specifikoj agjendat e punës dhe çështjet që do t"i trajtoj gjatë vitit në mënyrë që të përmirësoj funksionimin e kontrollit të brendshëm. | PO | 09.07.2014 | Nga viti 2011 është duke u zbatuar | Kryetari i komunës , dhe<br><br>Drejtorii njësisë së NJAB Dhe<br>Komiteti i Auditimit të brendshëm | Rekomandimi i dhënë nuk korrespondon me të gjeturat e vetë auditorit, sepse më të gjitha auditimet e kryera në fushëveprim të auditimit ka qenë periudha deri në momentin e auditimit. Pra edhe kur është audituar një periudhë e mëhershme (sipas shkallës së rrezikshmërisë), gjithsesi fushëveprimi ka përfshirë auditimin deri në momentin e auditimit. Auditimet në Tremujorin e I-rë të vitit zakonisht duhet përfshirë edhe periudhën e vitit paraprak, përshkak të mungesës së aktiviteteve (si është thënë edhe nga auditori).<br>Ka pasur raste kur auditimet janë kryer me kërkesë të Kryetarit të Komunës pavarësishtë për cilën periudhë.<br>Rekomandimi i dhënë nuk korrespondon me të gjeturat e vetë auditorit, sepse më të gjitha auditimet e kryera në fushëveprim të auditimit ka qenë periudha deri në |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | momentin e auditimit. Pra edhe kur është audituar një periudhë e mëhershme (sipas shkallës së rrezikshmërisë), gjithsesi fushëveprimi ka përfshirë auditimin deri në momentin e auditimit. Auditimet në Tremujorin e I-rë të vitit zakonisht duhet përfshirë edhe periudhën e vitit paraprak, përshkak të mungesës së aktiviteteve (si është thënë edhe nga auditori).<br>Ka pasur raste kur auditimet janë kryer me kërkesë të Kryetarit të Komunës pavarësishtë për cilën periudhë. |

**Me 16.07.2014**
**Gjilan**

**Kryetari i Komunës së Gjilanit:**
**/ z. Lutfi Haziri /**